

VAZHDON SAGA E KUVENDIT, SOT PËRPPJEKJA E 19



Janë bërë tre muaj qëkur janë mbajtur zgjedhjet parlamentare në vend, por institucionet e reja ende nuk janë konstituuar. Sot (e mërkurë) deputetët e Kuvendit do të mbledhen sërish, në përpjekjen e 19, për ta

zgjedhur kryetarin e Kuvendit. Deri më tani deputetët kanë kaluar vetëm dy pika të agjendës së seancës konstituive: raportin e Komisionit të Përkohshëm për Verifikimin e Mandateve dhe atë të Betimit të Deputetëve.

Por, procesi ka ngecur te pika e tretë: zgjedhja e kryeparlamentarit. Albulena Haxhiu, kandidate e LV-së për kryeparlamentare, po konsiderohet figurë përçarëse nga dy partitë politike, PDK-ja dhe AAK-ja

PDK-JA: ME BLOKADË POLITIKE DHE RRIJTJE ÇMIMESH, KURTI PO VËSHTIRËSON JETËN E QYTETARËVE F.4



BORDI I AKK-së DËNON GJUHËN DENIGRUESE TË MAPL-së, ALARMON PËR RREZIKIMIN E 15 MILIONË EUROVE NGA BE-ja F.7



AKTUALE



BE-ja MIRATON SANKSIONET E REJA KUNDËR RUSISË F.2

KOSOVA MERR NËN KONTROLL NJË OBJEKT NË LIQENIN E UJMANIT, SERBIA THOTË SE PËRDOREJ NGA KRYQI I KUQ F.3

POLICIA PËRMBYLL OPERACIONIN POLICOR KUNDËR AKTIVITETEVE TË JASHTËLIGJSHME NË RAJONIN E PRISHTINËS F.6

EKONOMI



KURSIMET PENSIONALE RIKTHEHEN NË RRIJTJE, FKPK SHËNON KTHIM POZITIV NË TË TRI PORTOFOLAT F.7

KOSOVA NDALON IMPORTIN E MISHIT TË PULËS NGA BRAZILI F.8

SPORT



TREPÇA KËRKON TITULLIN, BASHKIMI SERINË FINALE F.10

RENOVA

PUTZ

Maqedoni
Xhepçisht -Tetovë
Gurëz-Ferizaj

Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289

E-mail: renova@mt.net.mk

NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE

INFO: 049-111-101,
044-511-177

www.princesha-ks.com

Bunjimini
FABRIKA E LLAQEVE

044/256-051
044/367-061
028/532-617

MITROVICË

STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji
BIZNESI**

www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030-500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP

SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË

Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency

Endrit Shaqiri
+38344685122

Internet Website,
Marketing...

BE-ja miraton sanksionet e reja kundër Rusisë

BRUKSEL, 20 MAJ - Bashkimi Evropian (BE) e ka miratuar të martën një paketë të re sanksionesh kundër Rusisë për shkak të luftës në Ukrainë, duke goditur "flotën në hije" të cisternave të naftës së Moskës. Sanksionet kanë të bëjnë edhe me shkeljet e të drejtave të njeriut dhe kërcënimet hibride nga Moska, tha shefja e politikës së jashtme të BE-së, Kaja Kallas. "BE-ja ka miratuar paketën e saj të 17 të sanksioneve kundër Rusisë, duke shënjestruar pothuajse 200 anije të flotës në hije", shkroi Kallas në X. "Po përgatiten edhe më shumë sanksione kundër Rusisë. Sa më

shumë të zgjasë lufta e Rusisë, aq më e ashpër do të jetë përgjigja jonë", paralajmëroi ajo. Kompani nga vende si Vietnami, Serbia dhe Turqia, të akuzuara se ndihmojnë në furnizimin e ushtrisë ruse me mallra, gjithashtu do të përballen me kufizime. Dhjetëra zyrtarë rusë do t'i shtohen listës prej gati 2 400 personash dhe entitetesh që tashmë përballen me ndalime vizash dhe ngirije pasurish. Paketa përfshin sanksione ndaj individëve rusë për sulme kibernetike, shkelje të të drejtave të njeriut dhe akte sabotimi në Evropë.

BE-ja dhe aleatët e saj perëndimorë kanë ashpërsuar vazhdimisht masat kundër flotës në hije të cisternave ruse dhe aktorëve të lidhur me të, pasi ata përpiqen ta shmangin tavanin e vendosur nga Grupi i Shtatë vendeve (G7) për çmimin e naftës ruse, i cili është në fuqi që nga fundi i vitit 2022. Çmimet tavan u vendosën për ta lejuar shitjen e naftës ruse në vendet e treta duke përdorur shërbimet perëndimore të sigurimit përderisa çmimi nuk i kalon 60 dollarë për fuçi. Kjo lëvizje ka filluar të ketë ndikim dhe BE-ja do ta kërkojë uljen e mëtejshme të çmimit



tavan gjatë një takimi të ministrave të Financave të G7-s këtë javë në Kanada. Eksportet e naftës dhe gazit janë

një nga burimet kryesore të të ardhurave për Rusinë me të cilat ajo e financon luftën e saj në Ukrainë.

Franca "e vendosur" ta njohë shtetin palestinez

PARIS, 20 MAJ - Franca është "e vendosur" ta njohë një shtet palestinez, ka thënë të martën ministri i saj i Jashtëm, teksa ka dënuar Izraelin për situatën e "pajustifikueshme" në Gazë, të krijuar nga fushata ushtarake dhe nga bllokada e saj humanitare. Kryediplomati francez Jean-Noel Barrot ka thënë, po ashtu, se Parisi mbështet një iniciativë të udhëhequr nga Holanda për një rishikim të marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Izraelit, që mund t'i prekë marrëdhëniet politike dhe ekonomike, raporton AFP. Presidenti i Francës, Emmanuel Macron, e ka lënë të hapur mundësinë që Franca të bëhet vendi evropian i radhës që njeh një shtet palestinez, gjatë një konference të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, në qershor. "Ne nuk mund t'ua lëmë fëmijëve të Gazës një trashëgimi dhune dhe urrejtjeje. Prandaj, e gjithë kjo duhet të ndalet, dhe



pikërisht për këtë arsye ne jemi të vendosur ta njohim një shtet palestinez", ka thënë Barrot për radiostacionin France Inter. "Dhe, unë jam duke punuar aktivisht për këtë, sepse ne duam të kontribuojmë për një zgjidhje

politike në interes të palestinezëve, por edhe për sigurinë e Izraelit", ka shtuar ai. Barrot ka folur pasi Macron iu bashkua kryeministrit britanik, Keir Starmer, dhe atij kanadez, Mark Carney, në një komunikatë të

rrallë të përbashkët, e cila zemëroi Izraelin. Komunikata tha se "ne nuk do të rrimë duarkryq", kërcënoi "veprime të mëtejme konkrete" nëse Izraeli vazhdon bllokimin e ndihmave, dhe tha se "jemi të vendosur për njohjen e një shteti palestinez". I pyetur se çfarë do të mund të përfshinin këto veprime, Barrot përsëri i bëri thirrje BE-së për aprovim të kërkesës holandeze për rishikimin e marrëveshjes ndërmjet Izraelit dhe bllokut dhe, në veçanti, për hetimin e shkeljeve të mundshme të marrëveshjes nga ana e Izraelit. Kryeministri izraelit Benjamin Netanyahu ka autorizuar një sasi të kufizuar të ndihmave humanitare, pas mbi dy muajsh e gjysmë bllokade totale të territorit palestinez, i cili po përballlet me situatë katastrofike humanitare. Por, Barrot ka thënë se kjo është "absolutisht e pamjaftueshme". Situata në Gazë është e "pajustifikueshme për shkak të

dhunës pa dallim, dhe bllokimi u ndihmës humanitare nga qeveria izraelite e ka shndërruar Gazën në një kurth vdekjeje, nëse jo një varrezë". "Kur mbjell dhunë, korr dhunë", ka shtuar ai, duke paralajmëruar Izraelin. Lufta në Gazë nisi kur militantët e udhëhequr nga Hamasi sulmuan jugun e Izraelit, duke vrarë rreth 1 200 persona, kryesisht civilë, dhe duke marrë peng 251 të tjerë. Pjesëtarët e Hamasit janë ende duke i mbajtur 58 pengje që besohet të jenë gjallë, pasi shumica e pjesës tjetër janë liruar në kuadër të marrëveshjeve për armëpushim dhe të tjera. Ofensiva hakmarrëse e Izraelit, e cila ka shkakton pjesë të mëdha të Gazës, ka vrarë mbi 53 000 palestinezë, kryesisht gra dhe fëmijë, sipas Ministrisë së Shëndetësisë në Gazë, e cila nuk bën dallimin ndërmjet civilëve dhe luftëtarëve në llogaritjet e saj. Lufta ka zhvendosur rreth 90 për qind të popullatës së Gazës, shumicën prej tyre disa herë.

Parlamenti i Hungarisë miraton tërheqjen nga Gjykata Ndërkombëtare Penale

BUDAPEST, 20 MAJ - Parlamenti hungarez ka miratuar të martën propozimin për tërheqjen e vendit nga Gjykata Ndërkombëtare Penale (GjNP), me 134 vota pro, 37 kundër dhe 7 abstenime. Iniciativa u paraqit nga zëvendëskryeministri Zsolt Semjen. Sipas arsyetimit të qeverisë, GjNP është shndërruar në një aktor politik. Portali 24.hu raportoi në korrik të vitit të kaluar se pas kërkesës së Prokurorit të Përgjithshëm të GjNP-së për lëshimin e një fletarrestimi ndaj kryeministrit izraelit, Benjamin Netanyahu, për shkak të veprimeve ushtarake në Gazë, kryeministri hungarez,

Viktor Orban, kishte ngarkuar tre ministra të kabinetit të tij që të shqyrtonin pasojat e një tërheqjeje të mundshme nga Gjykata - si vendi i vetëm i Bashkimit Evropian që do ta bënte një hap të tillë. Sipas Shërbimit hungarez të Radios Evropa e Lirë, qeveria e Orbanit e interpretoi si sinjal pozitiv deklaratën e ish-presidentit amerikan, Donald Trump, më 5 shkurt, kur ky i fundit paralajmëroi sanksione ndaj GjNP-së pas fletarrestimit për Netanyahun. Pas lëshimit të urdhrit ndaj Netanyahun, Orban akuzoi GjNP-në se "po ndërhyr për qëllime politike në një konflikt në zhvillim", dhe tha se ky vendim e minon të drejtën ndërkombëtare. Ai deklaroi se do ta kundërshtonte



urdhurin dhe do ta ftonte Netanyahun për vizitë në Hungari, duke i garantuar se nuk do të arrestohej. Sipas qeverisë hungareze, kjo ishte e mundur sepse Parlamenti

hungarez nuk e kishte ratifikuar kurrë statutin e GjNP-së, prandaj ajo nuk kishte fuqi juridike në Hungari dhe nuk mund të zbatohet asnjë arrestim në bazë të saj.

Më 25 shkurt, ministri Gergely Gulyas tha se Qeveria po shqyrtonte seriozisht tërheqjen nga GjNP-ja, e cila kishte pasur edhe një gjykatës hungarez në përbërje deri në fund të mandatit të tij, vitin e kaluar. Ai tha se gjykata që dikur ishte një nismë e respektueshme, tani ishte "shndërruar në një aktor politik". Më 1 prill ministri i Drejtësisë, Bence Tuzson, kishte paraqitur në një takim të ambasadorëve, të mbajtur në Ministrinë e Punëve të Jashtme, skicën e procesit të tërheqjes. Dy ditë më pas, Gulyas njoftoi publikisht në rrjetet sociale se vendimi për t'u tërhequr ishte marrë. Ky vendim u konfirmua më 7 maj, me votimin përfundimtar të Parlamentit.

ISH-SHEFI I NATO-S: EVROPËS I DUHET NJË MODEL I RI SIGURIE

BRUKSEL, 20 MAJ - Ish-sekretari i përgjithshëm i Organizatës së Traktatit të Atlantikut Verior (NATO), Anders Fogh Rasmussen, i tha Radios Evropa e Lirë se përgatitjet për një forcë evropiane që do të vendosej në Ukrainë pas një armëpushimi ose marrëveshjeje paqeje “po ecin shumë ngadalë” dhe se i gjithë modeli i sigurisë evropiane është “në një pikë kthese”. “Nuk dua të shoh një koalicion të të gatshmëve që kthehet në një koalicion të pritësve”, tha Rasmussen, duke iu referuar një plani të shpallur nga kryeministri britanik, Keir Starmer, në Londër, më 2 mars. Që atëherë ka pasur një sërë takimesh në nivele të ndryshme. Megjithatë, pyetjet kyçe për mandatin e misionit, rregullat e angazhimit dhe se cilat vende do të dërgojnë trupa, ende nuk kanë marrë përgjigje publikisht. “Në parim, në Evropë, shpenzojmë shumë kohë duke diskutuar e folur, dhe përpjekjet për veprim janë të pakta”, tha Rasmussen. “Megjithatë, shpresoj që sulmi i [presidentit rus, Vladimir] Putin ndaj Ukrainës dhe zgjedhja e [Donald] Trumpit [president në Shtetet e Bashkuara të Amerikës] të shërbejnë si thirrje zgjimi që t’u tregojnë evropianëve se duhet të veprojmë shpejt”, shtoi ai. Rasmussen foli në një intervistë të gjerë mbi çështjet ushtarake, sigurinë ekonomike dhe komentet e përsëritura të presidentit amerikan Trump për



marrjen e Grenlandës nga Danimarka. Ai ishte kryeministër i Danimarkës përpara se të shërbente si sekretar i përgjithshëm i NATO-s, nga viti 2009 deri më 2014. “Është e turpshme ta kërcënohesh Danimarkën, një aleate të ngushtë, me mjete ushtarake për ta pushtuar Grenlandën”, tha Rasmussen. “Nuk mendoj se do të ndodhë. Por, në mënyrë të qartë, ekziston potenciali për të krijuar një ndarje brenda NATO-s kur kërcënon një aleat”, tha ai. Që prej largimit nga roli në NATO, Rasmussen ka krijuar organizatën jofitimprurëse Aleanca për Demokracitë, e cila synon të kundërshtojë atë që e përshkruan si ngritje globale të “autokratëve dhe diktatorëve”. Javën e kaluar, grupi shpalli një plan me pesë pika për mbrojtjen evropiane që përfshin një thirrje për rritjen e buxheteve të mbrojtjes në katër për qind të Prodhimit të Brendshëm Bruto (PBB) deri në vitin 2028.

Kjo pason lëvizjet e Bashkimit Evropian dhe fuqive të mëdha ushtarake të Evropës - Britania, Franca dhe Gjermania - për të rritur shpenzimet e mbrojtjes në vitet e ardhshme, por shkon përtej planeve të shpallura deri më tani. “Investimi i Rusisë në mbrojtje tani është më i madh se investimi i kombinuar i mbrojtjes në pjesën tjetër të Evropës. Kështu që, duhet të përshejtojmë. Duhet të dyfishojmë të paktën investimin evropian në mbrojtje”, i tha Rasmussen Radios Evropa e Lirë. “Për një kohë të gjatë, kemi mbështetur një model që nuk funksionon më - një kombinim i energjisë së lirë nga Rusia, mallrave të lira nga Kina dhe sigurisë së lirë nga ShBA”, shtoi ai. Çështjet e sigurisë dhe ekonomisë ishin tema kryesoret në një konferencë që Rasmussen organizoi javën e kaluar në Kopenhagë, ku u diskutua edhe plani me pesë

pika. Veterani 72-vjeçar i politikës dhe diplomacisë veçon tarifat globale të administratës Trump si një rrezik të ri që ka krijuar nevojën për një lloj “NATO-je ekonomike”. “Administrata Trump shpalli një luftë tregtare kundër të gjithë botës, përveç Rusisë dhe Koresë së Veriut”, tha ai. “Do ta sugjeroja krijimin e asaj që e quajmë D7, shtatë demokracitë e botës: Bashkimi Evropian, Mbretëria e Bashkuar, Kanada, Australia, Koreja e Jugut, Japonia dhe Zelanda e Re. Dhe, mendoj se shtylla kurrizore e kësaj do të ishte ajo që do ta quanim një Nen 5 ekonomik. Ne do ta konsideronim një sulm ose shtrëngim ndaj njërit prej atyre shtatë vendeve si një sulm ndaj të gjithëve, dhe do të përgjigjeshim në mënyrë kolektive”, shtoi ai. Është e habitshme të dëgjosh një ish-shef të NATO-s që përjashton Shtetet e Bashkuara nga një listë e demokracive globale. “Po, por Shtetet e Bashkuara kanë zgjedhur izolimin... Nuk shoh një gatishmëri amerikane për të ushtruar udhëheqjen globale të botës së lirë. Kështu që, për këtë arsye, SHBA-ja është përjashtuar nga kjo D7”, tha Rasmussen. Qeveritë në të gjithë botën po përballen me sfidën se si të reagojnë ndaj tarifave të Trumpit. Bashkëpunimi më i ngushtë dhe tregtia me partnerë të tjerë janë, pa dyshim, pjesë e

përllogaritjeve të tyre. Por, ashtu si me shpenzimet e mbrojtjes, propozimet e Rasmussenit shkojnë shumë përtej asaj që po konsiderohet në shumicën e kryeqyteteve. Për shembull, marrëveshja e shumëpërfolur e tregtisë së lirë e Bashkimit Evropian me katër shtete të Amerikës së Jugut në grupin Mercosur është përmendur si pjesë e përgjigjes kolektive të BE-së ndaj një mjedisi të ri, por Franca ende është shumë e kujdesshme për ta ratifikuar atë. Ndërkohë, BE-ja dhe vendet individuale kanë reaguar veçmas ndaj tarifave të ShBA-së, duke kërkuar të negociojnë me Uashingtonin në vend se të formojnë një front të përbashkët. Rasmussen nuk ofron përgjigje të thjeshta për zgjidhjen e rrjetit kompleks të interesave që e bëjnë të vështirë për shumë vende të krijojnë struktura të reja globale. Por, ai thotë se kjo është sfida që duhet kapërcyer. “Për të 19-tin vit radhazi, kemi parë një rënie të lirisë dhe demokracisë globale. Kështu që tani është koha për të krijuar një bashkëpunim më të fortë”, tha ai, duke shtuar se: “E di nga përvoja me Putinin dhe autokratë të tjerë se ata respektojnë vetëm forcën, unitetin dhe një qëndrim të vendosur... Nëse veprojmë së bashku, nëse veprojmë të bashkuar, atëherë mund të kundërshtojmë autokracitë që po përparojnë”, tha Rasmussen.

KOSOVA MERR NËN KONTROLL NJË OBJEKT NË LIQENIN E UJMANIT, SERBIA THOTË SE PËRDOREJ NGA KRYQI I KUQ

PRISHTINË, 20 MAJ - Autoritetet e Kosovës e kanë marrë nën kontroll të martën një ndërtesë buzë liqenit të Ujmanit në veri të vendit, duke nxitur reagime nga Serbia, e cila tha se ndërtesa përdorej nga Kryqi i Kuq. Zëvendësdrejtori i Policisë së Kosovës për veriun, Veton Elshani, tha për Radion Evropa e Lirë (REL) se policia ka asistuar në aksionin për marrjen nën kontroll të këtij objekti. Vendimi i së martës është më i fundit në një sërë veprimesh të autoriteteve të Kosovës për t'i mbyllur institucionet paralele serbe në territorin e Kosovës. Ditë më parë ato morën nën kontroll objektin e Shërbimit Kombëtar të Punësimit në Mitrovicën e Veriut, si dhe mbyllën edhe hapësirat e palestër sportive, muzeut të qytetit, Institutit për Kulturë,

Rini, Sport dhe Shërbime të Specializuara, si dhe të Shoqatës Kulturore-Artistike “Kosovski Bozhur”. Drejtori i Zyrës për Kosovën në Qeverinë e Serbisë, Petar Petković, dhe Lista Serbe - partia më e madhe e serbëve në Kosovë - e dënuan vendimin e autoriteteve të Kosovës, duke thënë se e kanë ndërprerë punën e “njërës prej organizatave humanitare më të vjetra dhe më të rëndësishme në botë”. Petković tha se ky është një objekt që është përdorur “ekskluzivisht për trajnimin e fëmijëve dhe pjesëmarrësve në kurset e Kryqit të Kuq, trajnime në fushën e ndihmës së parë dhe shpëtimit, gara të ndryshme sportive, trajnime dhe ligjërata, akomodimin e turistëve dhe sportistëve që qëndronin në këtë pjesë të Kosovës”. “Ndërhyrja brutale e njësive të



Policisë së Kosovës në objektin në liqenin e Gazivodës, i cili i përket Kryqit të Kuq të Kosovës dhe Metohisë, me urdhër të Albin Kurtit, përbën një shkelje të rëndë të të gjitha konventave ndërkombëtare përkatëse”, tha Lista Serbe në një reagim. Ajo tha se në këtë objekt “Kryqi i

Kuq i Kosovës dhe Metohisë... gjatë viteve të veprimtarisë së tij ka bashkuar të gjitha komunitetet dhe ka ofruar ndihmë pa përjashtim për anëtarët e të gjitha komuniteteve - serbë, shqiptarë, romë, boshnjakë dhe të tjerë”. Ditë më parë Bashkimi Evropian

reagoi duke vlerësuar se veprimet e autoriteteve të Kosovës në veri rrezikojnë ngritjen e tensioneve në terren dhe ndikojnë negativisht në jetën e përditshme të komuniteteve lokale dhe në imazhin ndërkombëtar të Kosovës.



VAZHDON ŞAGA E KUVENDIT, SOT PËRPJËKJA E 19

Janë bërë tre muaj qëkur janë mbajtur zgjedhjet parlamentare në vend, por institucionet e reja ende nuk janë konstituuar. Sot (e mërkurë) deputetët e Kuvendit do të mbledhen sërish, në përpjekjen e 19, për ta zgjedhur kryetarin e Kuvendit. Deri më tani deputetët kanë kaluar vetëm dy pika të agjendës së seancës konstituive: raportin e Komisionit të Përkohshëm për Verifikimin e Mandateve dhe atë të Betimit të Deputetëve. Por, procesi ka ngecur te pika e tretë: zgjedhja e kryeparlamentarit. Albulena Haxhiu, kandidate e LV-së për kryeparlamentare, po konsiderohet figurë përçarëse nga dy partitë politike, PDK-ja dhe AAK-ja

**EPOKA
ERE****Mal QORRAJ**

Prishtinë, 20 maj - Për të tetëmbëdhjetën herë me radhë deputetët e Kuvendit të Kosovës kanë dështuar të hënë ta konstituojnë përbërjen e nëntë parlamentare të dalë nga zgjedhjet e shkurtit. Ata sot (e mërkurë) do të mbledhen sërish për një përpjekje të re të konstituimit të Kuvendit. Ligjbërësit refuzuan për të dhjetën herë rresht që ta formonin një komision për mbikëqyrjen e një votimi të fshehtë për kreun e ri të organit ligjvënës. Çështja e votimit të fshehtë - që u propozua më 1 maj nga kryesuesi i seancës, Avni Dehari, pasi e propozuara e Lëvizjes Vetëvendosje (LV) për kryetare të Kuvendit, Albulena Haxhiu, nuk arriti në disa votime t'i merrte 61 votat e nevojshme për t'u konfirmuar në post - është dërguar në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës nga partitë që në legjislaturën e kaluar ishin në opozitë. Ato thonë se është jokushtetuese mënyra se si LV-ja po tenton që kryeparlamentari të votohet përmes formës së fshehtë dhe i kanë kërkuar Kushtetueses të marrë "një masë të përkohshme për ndalim të mbajtjes së seancave, derisa me prioritet ta

trajtojë këtë lëndë dhe ta marrë një vendim". Partia Demokratike e Kosovës (PDK), Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) dhe Lista Serbe refuzuan sërish, në vazhdimin e seancës konstituive, më 19 maj, që ta propozonin një përfaqësues që do ta siguronte mbarëvajtjen e votimit të fshehtë. Deri më tani deputetët kanë kaluar vetëm dy pika të agjendës së seancës konstituive: raportin e Komisionit të Përkohshëm për Verifikimin e Mandateve dhe atë të Betimit të Deputetëve. Por, procesi ka ngecur te pika e tretë: zgjedhja e kryeparlamentarit. Haxhiu e LV-së po konsiderohet figurë përçarëse nga dy parti parlamentare, PDK-ja dhe AAK-ja. Këto dy subjekte kanë kërkuar që LV-ja të nxjerrë emër tjetër për kryeparlamentar. LDK-ja, ndërkaq, ka thënë se nuk ka vota për asnjë të propozuar të LV-së për kryeparlamentar. Propozimi për kryeparlamentar është e drejtë ekskluzive e fitueses së zgjedhjeve, LV-së, e cila ngul këmbë se Haxhiu e meriton të zgjidhet dhe, ndonëse ka kërkuar marrëveshje politike me partitë e tjera, e ka përjashtuar mundësinë të sjellë kandidat

tjetër pos saj. Të enjten, pas një takimi të thirrur nga presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, me përfaqësues të partive politike, Osmani tha se nuk pati pajtim rreth konstituimit të Kuvendit, por shtoi se kishte parë një "disponim minimal" te liderët partiakë për të gjetur një zgjidhje për këtë çështje. Deputetët duhet ta zgjedhin kryetarin dhe pesë nënkryetarët për ta konstituuar përfundimisht Kuvendin e ri. Vetëm pas konstituimit të Kuvendit mund të formohet qeveria e re. Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) ka dërguar në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës çështjen e votimit të fshehtë për kryetarin e Kuvendit të Kosovës. Kërkesa, e paraqitur nga deputetë nga radhët e AAK-së dhe e mbështetur edhe nga deputetë të Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) dhe të Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), erdhi në mes të ngërçit në Kuvendin e Kosovës, i cili nuk është konstituuar as pas 18 përpjekjeve rresht, kur kanë kaluar tre muaj nga mbajtja e zgjedhjeve. "Si Aleancë për Ardhmërinë e Kosovës, me nënshkrimet e deputetëve të Aleancës, të Lidhjes Demokratike të Kosovës, por edhe të Partisë Demokratike të

Kosovës, e kemi dërguar në Gjykatë Kushtetuese për interpretim ndryshimin e votimit në mes të procedurave për zgjedhjen e kryeparlamentarit", tha deputetja e AAK-së, Time Kadrijaj, para gazetarëve. "Kërkuam nga Gjykata Kushtetuese që kjo të trajtohet me prioritet... Duke konsideruar që është shkelje ligjore, po mendojmë që po zhvleftësohet vlera e Kuvendit të Kosovës, duke mbajtur seanca plenare çdo 48 orë, dhe seanca [me të cilat] konsiderojmë që po shkelet Kushtetuta e Kosovës", u shpreh ajo. "I lutëm aktorët që ta trajtojnë me prioritet, ndoshta edhe me një pezullim të përkohshëm, me një masë të përkohshme për ndalim të mbajtjes së seancave, derisa Gjykata me prioritet ta trajtojë këtë lëndë dhe ta marrë një vendim", tha Kadrijaj. Lideri i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, ka ngulur këmbë se nuk do ta ndryshojë kandidatin për kryetar të Kuvendit, me gjithë mungesën e votave, duke thënë se emërimi i kryeparlamentarit dhe formimi i Kuvendit të ri është detyrë e të gjitha partive parlamentare. "Kuvendi nuk themelohet nga fituesi, pavarësisht se a është ai fitues absolut apo relativ, Kuvendi themelohet nga të gjithë dhe bashkë; nga vendi i

parë së bashku me vendin e dytë, tretë dhe pakicat serbe dhe joserbe", kishte thënë Kurti duke folur në një mbledhje të Këshillit të Përgjithshëm të partisë. Në këtë klimë të zymtë politike, qytetarët ndihen gjithnjë e më të distancuar nga politika. Papunësia, ikja e të rinjve dhe mungesa e investimeve janë tema që prekin përditshmërinë e tyre, por që rrallë gjejnë vend në agjendat e debatit politik. Sipas një sondazhi të fundit, mbi 65 % e qytetarëve të Kosovës e konsiderojnë klasën politike të paafte për t'i adresuar problemet reale të vendit. Kjo shifër është sinjal alarmi për të gjithë spektrin politik. Ndërsa zërat për zgjedhje të parakohshme po shtohen, dilema e madhe është nëse një cikël i ri zgjedhor do ta zgjidhë ngërçin, apo do ta thellojë atë më tej. Me skena politike të fragmentuara, mungesë të koalicioneve funksionale dhe polarizim ekstrem, zgjedhjet mund të prodhojnë një pasqyrë edhe më të ndërlikuar politike. Kosova ka nevojë urgjente për një platformë të gjerë dialogu politik, për ta shpëtuar funksionalitetin institucional dhe për ta ruajtur stabilitetin demokratik. Përndryshe, ngërçi politik rrezikon të kthehet në një krizë të thellë sistemore.

Osmani e takon Limajn lidhur me përpjekjet për konstituimin e Kuvendit

PRISHTINË, 20 MAJ - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, e ka takuar kryetarin e Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, si pjesë e konsultimeve të saj politike në përpjekje për ta zhbllokuar ngërçin në

Kuvendin e Kosovës, i cili ka mbetur i pakonstituuar edhe tre muaj pas zgjedhjeve. Në një njoftim të shkurtër në “Facebook”, Presidenca tha se takimi vjen pas kërkesës së pranuar nga Nisma për takim.

Presidenca nuk dha hollësi për atë që u bisedua në këtë takim, ndërsa Limaj nuk ka folur rreth tij deri tani. Nisma i fitoi tri ulëse në Kuvend në zgjedhjet e 9 shkurtit, në të cilat garoi në

një koalicion me Aleancën për Ardhmërinë e Kosovës (AAK). Takimi në mes të Osmanit dhe Limajt vjen pasi deputetët dështuan për herën e tetëmbëdhjetë radhazi ta formojnë Kuvendin.



PDK-JA: ME BLLOKADË POLITIKE DHE RRIJTJE ÇMIMESH, KURTI PO VËSHTIRËSON JETËN E QYTETARËVE

PRISHTINË, 20 MAJ - Anëtari i kryesisë së Partisë Demokratike të Kosovës, Arben Mustafa, ka alarmuar për përshpejtim të rritjes së çmimeve të produkteve bazë, në këtë periudhë kur Lëvizja Vetëvendosje ka vendosur ta bllokojë Kuvendin, përderisa po e mban të uzurpuar pushtetin qeveritar. Mustafa në një konferencë për medie tha se të dhënat e muajit prill tregojnë për rritje dyshifrore të çmimeve të produkteve bazë të cilat e prekin çdo familje. “Të dhënat e muajit prill tregojnë për rritje dyshifrore të çmimeve të produkteve bazike, të cilat prekin çdo qytetar, çdo familje. Çmimet e produkteve si mishi, vajrat dhe yndyrat, pemët, si dhe kafja e çaji u rritën me nga 10 deri në 16.4 %. Në anën tjetër, punëtorët, pensionistët dhe përfituesit e kategorive të ndryshme sociale vazhdojnë të mos kenë rritje të të hyrave. Pra, vazhdojnë të jenë të braktisur në kohën kur shpenzimet e jetesës çdo ditë e më tepër po bëhen më të papërbalueshme”, ka theksoi Mustafa. Ai shtoi se ekonomia e vendit po vazhdon të ballafaqohet me përkeqësim të mëtejshëm të deficitit tregtar si pasojë e rënies së eksporteve dhe rritjes së importeve, duke theksuar se vetëm në tre muajt e parë të këtij viti ky deficit arriti në 1.4 miliardë euro. Sipas Mustafës, ky pozicion i pafavorshëm tregtar për biznese pritet të thellohet



edhe më tutje përmes masave për pengimin e furnizimit me energji brenda vendit. “Vendimi për të nxjerrë bizneset në tregun e hapur të furnizimit me energji, pa asnjë masë përgatitore dhe pa u siguruar se do të ketë konkurrencë të mirëfilltë në tregun e furnizuesve të energjisë, pritet të rrisë me rreth 260% shpenzimet e furnizimit me energji për bizneset që kanë mbi 50 punëtorë apo mbi 10 milionë euro qarkullim vjetor. Një

shtrenjtim kaq i madh i faturës së energjisë për disa biznese mund të nënkuptojë mbyllje të biznesit, ndërsa për një pjesë tjetër goditje të madhe në pozicionin konkurrues, duke i bërë eksportet e kompanive kosovare shumë më të shtrenjta dhe si pasojë, edhe më të pakta se që janë aktualisht. Më pak eksporte nga kompanitë kosovare do të thotë më pak vende pune në Kosovë, më pak të ardhura për familjet kosovare dhe më pak

tatime të paguara për shtetin e Kosovës. Me një fjalë, kjo qeveri po e godet rëndë sektorin privat dhe me këtë po godet shtyllën kryesore të punësimit dhe të gjenerimit të të ardhurave për familjet kosovare”, tha ai. Mustafa konsideron se Albin Kurti nuk ka ndjeshmëri as ndaj këtij kërcënimi të hapur që po i kanoset ekonomisë së Kosovës, prandaj edhe nuk sheh urgjencë të hapjes së rrugës për zhbllokimin e institucioneve të vendit. “Çdo

ditë shtesë e kësaj bllokade po rëndon mbi të tashmen dhe të ardhmen e shtetit të Kosovës, si dhe mbi cilësinë e jetës së çdo familjeje në Kosovë. Prandaj, edhe sot i bëjmë thirrje partisë që ka dalë e para në zgjedhje, ta marrë përgjegjësinë që i takon për zhbllokimin e procesit të konstituimit të Kuvendit dhe të hapë rrugë për krijimin e një qeverie të përgjegjshme që punon për një jetë më të mirë për qytetarët e Kosovës”, përfundoi Mustafa.

Presidentja Osmani kërcënohet me jetë, thotë këshilltari i saj

PRISHTINË, 20 MAJ - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, është kërcënuar me jetë gjatë kësaj jave, tha këshilltari i saj për medie, Bekim Kupina. Në një njoftim për medie ai tha se “kërcënimi i kësaj jave është vazhdimësi e kërcënimeve të vazhdueshme me jetë ndaj presidentes Osmani”. Kupina i kritikoi autoritetet e drejtësisë për “mosveprimin” e tyre në këto raste. “Përkundër dhjetëra kërcënimeve - shumica prej tyre kërcënime

me jetë - asnjë veprim nuk është ndërmarrë ndaj kërcënuesve për vite me radhë”, tha ai. Kupina tha se “në shumicën e rasteve” kërcënimet bëhen me “emër, mbiemër dhe nga profile të identifikueshme”, por nuk dha më shumë hollësi rreth kërcënimeve apo kërcënuesve. “Disa kërcënime janë bërë madje edhe në emisione televizive, por edhe atëherë kanë munguar veprimet për t’i përballur kërcënuesit me përgjegjësi”,

nënvizoi ai. Sipas tij, rasti i kërcënimeve “të njëpasnjëshme me jetë ndaj presidentes dhe familjes së saj është i vetmi në historikun e institucioneve, siç na është thënë nga institucionet e sigurisë, ku asnjë nga kërcënuesit nuk është përballur me drejtësinë”. “Kjo klimë e rrezikshme nxit të tjerë ta ndjekin të njëjtin model: nxitje dhune, thirrje për eliminim fizik dhe përçmim të plotë ndaj rendit kushtetues”, shtoi ai.



BORDI I AKK-SË DËNON GJUHËN DENIGRUESE TË MAPL-së, ALARMON PËR RREZIKIMIN E 15 MILIONË EUROVE NGA BE-ja

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 20 MAJ - Bordi i Asociacionit të Komunave të Kosovës (AKK) ka reaguar ndaj gjuhës shpifëse, denigruese dhe joetike të përdorur në demantin zyrtar të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), i cili, përveç që përbën një sulm të paprecedent institucional ndaj drejtorit ekzekutiv të AKK-së, Sazan Ibrahim, përbën gjithashtu një përpjekje të hapur për ta shmangur përgjegjësinë për një çështje me rëndësi strategjike për vetë komunat e Republikës së Kosovës: vazhdimësinë e financimit të Grantit të Performancës Komunale. Në vend të një përgjigjeje profesionale dhe substanciale ndaj kërkesës zyrtare të parashtuar nga kryetari i AKK-së, Agim Aliu, më 5 maj 2025, ku kërkohet sqarim për aplikimin dhe fatin e fondeve nga thirrja e IPA III 2025-2027 “EU for Good Governance”, MAPL ka zgjedhur ta sulmojë personalisht Ibrahim, duke i atribuar

qëndrimet e Bordit të AKK-së si “interesa personale” dhe duke aluduar në motive të ulëta që bien ndesh me etikën e komunikimit institucional dhe me respektin ndaj përfaqësuesve të 38 komunave të vendit. “Sqarojmë qartë dhe prerazi se: 1. Çdo qëndrim, deklaratë dhe kërkesë e adresuar nga AKK-ja ndaj MAPL-së është e miratuar dhe përfaqëson vullnetin kolektiv të Bordit të AKK-së, i përbërë nga kryetarët e komunave anëtare dhe nuk përfaqëson në asnjë mënyrë ndonjë interes personal apo përfitim individual të askujt. 2. Përgjigja arrogante dhe denigruese e MAPL-së nuk ofron asnjë informacion konkret apo teknik në lidhje me pyetjet thelbësore të ngritura në kërkesën tonë zyrtare, që lidhen me të ardhmen e një mekanizmi financiar jetik për zhvillimin komunal – siç është Granti i Performancës. 3. Fyerjet ndaj z. Sazan Ibrahim janë të papranueshme, të pabazuara dhe cenojnë integritetin e një personi që prej më shumë se dy dekadash ka përfaqësuar me



profesionalizëm interesat e komunave të Republikës së Kosovës në raport me institucionet vendore dhe ndërkombëtare. Një fyerje e tillë është, në thelb, fyerje ndaj të gjitha komunave që ai përfaqëson. 4. MAPL-ja ka dështuar të ofrojë sqarime zyrtare lidhur me statusin e aplikimit në fondet e IPA III, dhe ky dështim rrezikon seriozisht vazhdimësinë e financimit të një

skeme që ka ndihmuar në përmirësimin e performancës dhe shërbimeve për qytetarët”, theksohet në reagimin e Bordit të AKK-së. Bordi i AKK-së i ka bërë thirrje MAPL-së ta tërheqë gjuhën fyese të përdorur në demant, të kërkojë falje publike për shpifjet ndaj Ibrahimit dhe të rikthehet në rrugën e bashkëpunimit institucional me përfaqësuesit legjitimë të komunave të

Kosovës. “Gjithashtu, u kërkojmë partnerëve ndërkombëtarë që e kanë mbështetur për vite të tëra Grantin e Performancës Komunale të ndjekin me kujdes zhvillimet e fundit, pasi rrezikohen standardet e transparencës dhe llogaridhënies në procesin e tranzicionit të menaxhimit të këtij Granti”, thuhet në reagimin e Bordit të AKK-së.

POLICIA PËRMBYLL OPERACIONIN POLICOR KUNDËR AKTIVITETEVE TË JASHTËLIGJSHME NË RAJONIN E PRISHTINËS

EPOKA E RE **Qendresa RAMA**

PRISHTINË, 20 MAJ - Drejtoria Rajonale e Policisë së Prishtinës ka realizuar me sukses një operacion të gjerë policor në funksion të luftimit të veprimtarive të kundërligjshme që ndërlidhen me organizimin e skemave piramidale dhe lojërave të fatit - bixhozit të jashtëligjshëm. Operacioni është zhvilluar në vazhdimësi që nga data 25 prill 2025, pas pranimit të informatave të besueshme për zhvillimin e aktiviteteve të tilla të kundërligjshme në disa lokacione të rajonit të Prishtinës. Operacioni ka rezultuar tejet i suksesshëm, me ç’rast janë inspektuar me sistem monitorimi 75 lokacione të ndryshme, përfshirë këtu shtëpi, lokale afariste dhe objekte përcjellëse. Në 25 prej tyre janë bërë



kontrolle. Shtatë lokale janë mbyllur nga inspektorët e Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, si dhe inspektoratet komunale për mungesë të dokumentacionit përkatës ose licencave. Gjithashtu, janë iniciuar 10 raste penale, janë evidentuar

shënime zyrtare dhe raporte operative që lidhen me vepra penale të ndryshme, si organizim i lojërave të fatit, posedim i paautorizuar i substancave narkotike, armëmbajtje pa leje, kultivim, përpunim dhe shitje e substancave narkotike.

Janë arrestuar 14 persona, të dyshuar për përfshirje në këto aktivitete të paligjshme. Nga ta, 7 janë ndaluar me masë mbajtjeje prej 48 orësh, ndërsa 7 të tjerë janë liruar në procedurë të rregullt. Përgjatë operacionit janë sekuestruar në cilësi të provave

të rëndësishme edhe 13 aparate për lojëra të fatit; 1 armë automatike AK-47, 1 armë e ftohtë (thikë) dhe 1 boks metalik; pajisje laboratorike për përpunimin e substancave narkotike, përfshirë një sasi të dyshuar narkotikësh në qese plastike; 2,726 euro para të gatshme; 2 laptopë, 1 printer, një çantë me çipa dhe 15 palë letra bixhozi, si dhe 3 telefona mobil, të dyshuar se janë përdorur për pagesa online në bastore sportive. Policia e Kosovës mbetet e përkushtuar dhe e palëkundur në angazhimin e saj për parandalimin dhe luftimin e veprimtarive të jashtëligjshme që cenojnë rendin dhe sigurinë publike. Ky operacion dëshmon edhe njëherë profesionalizmin, bashkëpunimin institucional dhe përkushtimin e zyrtarëve policorë në mbrojtje të ligjshmërisë dhe interesit të qytetarëve.

Bislimi thekson angazhimin e palëkundur të Kosovës në procesin e integritetit evropian

PRISHTINË, 20 MAJ - Zëvendëskryeministri i parë në detyrë për Integrim Evropian, Zhvillim dhe Dialog i Republikës së Kosovës, Besnik Bislimi, ka pritur në takim shefin e Divizionit për Kosovë pranë Komisionit Evropian, Jiri Plecity. Gjatë takimit zëvendëskryeministri Bislimi

theksoi përkushtimin dhe angazhimin e palëkundur të Kosovës në procesin e integritetit evropian dhe rrugën drejt aderimit në familjen evropiane. Ai theksoi edhe nevojën e menjëhershme për heqjen e masave ndaj Kosovës, të cilat u vendosën padrejtësisht dhe vazhdojnë të mbeten në fuqi

padrejtësisht, pavarësisht prej rekomandimit nga ish-përfaqësuesi i lartë i BE-së, Josep Borrell, rekomandim i cili është dhënë pothuajse një vit më parë tashmë. Zëvendëskryeministri Bislimi e falënderoi Plecityn për takimin dhe bisedën, duke i uruar qëndrim të mbarë dhe të frytshëm në Kosovë.



Smajl Latifi synon mandatin e katërt të kryetarit të Rahovecit

Rahovec, 20 maj - Me miratimin e Degës së AAK-së në Rahovec, Smajl Latifi ka shpallur zyrtarisht kandidaturën për një mandat të katërt për kryetar të komunës së Rahovecit. Lajmin e ka dhënë Dega e AAK-së në këtë komunë. “Qytetarë të dashur të

Rahovecit, pas tri mandateve të suksesshme dhe me përparime të dukshme, Smajl Latifi, kryetari aktual i komunës sonë, me mbështetjen e Degës së AAK-së në Rahovec, kandidon sërish për të vazhduar rrugën e zhvillimit. Le ta vazhdojmë së bashku këtë rrugëtim drejt një

Rahoveci më të fortë, më të begatë dhe më frymëzues! Bashkimi ynë është çelësi i fitores. Me Smajl Latifin në krye, e ardhmja e Rahovecit është në duar të sigurta. Na priftë e mbara!”, thuhet në njoftimin e Degës së AAK-së në Rahovec.



AKB-ja DHE SINDIKATA E SEKTORIT PRIVAT: TREGU I HAPUR ENERGJETIK RREZIKON VENDET E REJA TË PUNËS



PRISHTINË, 20 MAJ - Kryetari i Aleancës Kosovare të Bizneseve, Agim Shahini, ka pritur në zyrat e AKB-së kryetarin e Sindikatës së sektorit privat, Isuf Azemi, ku është zhvilluar një takim i frytshëm për të diskutuar për gjendjen e punëtorëve në përgjithësi, në veçanti në sektorin privat, si dhe ndikimin e krizës institucionale në ekonominë e vendit. Të dyja palët u pajtuan se, ndonëse gjendja e punëtorëve

në sektorin privat ka shënuar përmirësime të dukshme, sfidat mbesin të shumta. Një ndër çështjet më shqetësuese mbetet rritja e çmimit të energjisë elektrike dhe liberalizimi i tregut energjetik, i cili pritet t'i godasë rëndë kompanitë me mbi 50 të punësuar dhe qarkullim mbi 10 milionë euro. Përfaqësuesit e AKB-së dhe të Sindikatës u shprehën se kriteret e reja të Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRrE)

janë të papranueshme dhe mund të ndikojnë negativisht në punësimin e ri të punëtorëve dhe stabilitetin ekonomik të ndërmarrjeve. Në përfundim të takimit, AKB-ja dhe Sindikata e Pavarur e Sektorit Privat u pajtuan ta thellojnë bashkëpunimin e ndërsjellë me qëllim të përmirësimit të kushteve të punës, zhvillimit ekonomik dhe mbrojtjes së interesave të punëtorëve në Kosovë.

RAMA: NDËRMARRJA ‘PASTRIMI’ NDODHET NË GJENDJE TË RËNDUAR PËR SHKAK TË KEQMENAXHIMIT

PRISHTINË, 20 MAJ - Kryetari i Prishtinës, Përparim Rama, ka thënë të martën se ndërmarrja “Pastrimi” ndodhet në një gjendje të rënduar për shkak të keqmenaxhimit të vazhdueshëm dhe mungesës së përgjegjshmërisë së menaxhmentit. “Në këtë situatë të krijuar, në kuadër të bashkëpunimit ndërkomunal, komunat do t'i ndihmojnë njëra-tjetrës sipas nevojës së krijuar. Komuna e Prishtinës, në koordinim me komunat e tjera aksionare, do të ndërmarrë veprime për të ndihmuar në stabilizimin e situatës në ndërmarrje, me synim

që të mbrohet mirëqenia e punëtorëve, pagat dhe vendet e tyre të punës, si dhe të sigurohet funksionimi normal i ndërmarrjes”, ka thënë ai, duke shtuar se komunat do të angazhojnë operatorë privatë për ta siguruar vazhdimësinë e mbledhjes së mbeturinave në territoret përkatëse, me qëllim mbrojtjen e shëndetit publik dhe garantimin e një mjedisi të pastër. “Komunat kanë shprehur vullnetin e tyre të lirë për t'i iniciuar menjëherë procedurat e decentralizimit të ndërmarrjes në përputhje me legjislacionin në fuqi”, ka thënë Rama.



KURSIMET PENSIONALE RIKTHEHEN NË RRRITJE, FKPK SHËNON KTHIM POZITIV NË TË TRI PORTOFOLAT

PRISHTINË, 20 MAJ - Fondi i Kursimeve Pensionale i Kosovës ka njoftuar kontribuuesit dhe palët e interesuara se të gjithë portofolat investuese të FKPK-së tashmë janë rikthyer në nivel pozitiv edhe për vitin 2025. Sipas një njoftimi për medie, bëhet me dije se për datën e fundit të raportimit (15 maj 2025), investimet e FKPK-së për këtë vit kanë këtë rezultat:



“Portofoli konservativ +1.26% – për moshën 63+ vjeç. Portofoli balancuar +1.01% – për moshën 58-62 vjeç. Portofoli standard +0.18% – për moshën 15 deri 57 vjeç”, thuhet në njoftim. Po në njoftim bëhet me dije se ky rikuperim erdhi pas rënies të theksuara në tregjet financiare globale, të cilat gjatë marsit dhe prillit i kishin prekur kursimet e kontribuuesve të FKPK-së të

moshës deri në 63 vjeç. Ndërsa kontribuuesit e moshës 63-vjeçare e sipër, sipas njoftimit, kanë qenë vazhdimisht të mbrojtur nga luhajtjet, duke realizuar kthim pozitiv nga investimet. “Ritheksojmë se në afatgjatë FKPK-ja ka dëshmuar ngritje të vlerës nga investimet dhe ka akumuluar rreth 1 miliard euro kthim bruto nga investimet (prej themelimit e deri më tani)”, thuhet në njoftim.

Anëtarët e rinj të KQZ-së betohen para presidentes Osmani

PRISHTINË, 20 MAJ - Anëtarët e rinj të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, të propozuar nga partitë politike të përfaqësuara në Kuvendin e

Kosovës, kanë dhënë betimin para presidentes së Republikës së Kosovës, Vjosa Osmani. Gjatë ceremonisë anëtarët e

rinj u zotuan se do t'i kryejnë detyrat e tyre me ndershmëri, besnikëri, paanësi, profesionalizëm dhe përgjegjësi të lartë.



Kosova ndalon importin e mishit të pulës nga Brazili

PRISHTINË, 20 MAJ - Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë njofton qytetarët se duke filluar nga data 20 maj 2025, ndalon përkohësisht importin e mishit të pulës dhe produkteve të tjera të shpendëve nga Brazili. Në njoftim thuhet se kjo masë është ndërmarrë si përgjigje ndaj shpërthimit të gripit të shpendëve (H5N1) në një fermë komerciale në shtetin Rio Grande të Brazilit, i konfirmuar më 16 maj 2025 nga autoritetet braziliane. “Ky vendim synon të mbrojë

shëndetin publik dhe të parandalojë përhapjen e mundshme të sëmundjes në territorin e Kosovës. Gripi i shpendëve është një sëmundje virale shumë ngjitëse që prek shpendët dhe, në raste të rralla, mund të transmetohet edhe te njerëzit. Megjithëse nuk ka prova që konsumimi i mishit apo vezëve të shpendëve mund të shkaktojë infeksion, mirëpo ndalimi i importit është një masë paraprake për të garantuar sigurinë ushqimore të qytetarëve”, thuhet në

njoftim. AUV njofton se ky vendim është në përputhje me praktikat ndërkombëtare dhe veprimet e ndërmarra nga vende të tjera, përfshirë Bashkimin Evropian, Kinën dhe vende të tjera të cilat kanë pezulluar importet e mishit të pulës nga Brazili pas konfirmimit të shpërthimit. Agjencia më tutje bën me dije se ndalimi do të mbetet në fuqi deri në një njoftim të dytë, gjithmonë bazuar në situatën epidemiologjike në Brazil dhe rivlerësimit të rrezikut nga AUV.



BAJRAMI, KRITIKA NDAJ LV-së PËR DËMTIMIN E BIZNESEVE VENDORE: NGA ‘DUAJE TËNDEN’, NË ‘SHKATËRRO TËNDEN’

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 20 MAJ - Deputetja e LDK-së, Hykmete Bajrami, ka thënë se disa prej deputetëve të LV-së në qeveri kishin mbledhur odat dhe shoqatat e biznesit kinse për t'i dëgjuar brengat e tyre lidhur me liberalizimin e tregut të energjisë, proces ky që po ua rrit faturat deri në 260 % rreth 1 300 bizneseve. “A e dini cila është kërkesa e bizneseve? Kërkesa është që vendimi për liberalizim të tregut të energjisë të shtyhet për një vit - kaq. Por, në vend që një kërkesë e tillë të merrej parasysh, ata që ende e quajnë veten ministra paskan thënë se këto biznese do t'i ndihmojnë duke ua subvencionu izolimin e ndërtesave. Merreni me mend: një metal përpunuesi te i cili rryma është 30% e koston së prodhimit, këta i thonë ta izolojmë ndërtesën dhe të ndihmojnë me vokë ujin. Kaq dinë këta ose kaq mund të thonë, pasi veç prioritet prodhimin vendor nuk e kanë”, ka shkruar



Bajrami në “Facebook”. Ajo ka shtuar tutje se: “A e dini se si justifikohen për tregtarët, Qeveria thonë ‘nuk iu subvencion energjinë korporatave që fitojnë qindra miliona euro’. Si injorantë që janë, këta nuk marrin parasysh faktin se ata prapë

do të fitojnë qindra miliona euro, por kostot shtesë do t'i paguajnë qytetarët e vendit, ata me të ardhurat më të vogla, sepse çmimet do të rriten - e do të rriten çmimet e produkteve që shiten më së shumti - do të rriten çmimet e produkteve të konsumit të

përditshëm, por as për qytetarët këta nuk mërzen”. Deputetja Bajrami ka thënë se për të hyrë e për t'i analizuar të dhënat e tregtimit të energjisë, çdokush e kupton se këto politika janë krejt në favor të “mafies energjetike”. “Me hy dhe me i analizu të dhënat e tregtimit të energjisë, çdo kush e kupton se këto politika janë krejt në favor të ‘mafies energjetike’, për të cilën deputeti Albin Kurti ka folur para se të bëhej kryeministër. Qysh atëherë, deputeti Kurti, si inteligjent që është, e ka ditur në tërësi rrjetin e tyre dhe mënyrën e funksionimit. Nga ‘duaje tënden’ në ‘shkatërro tënden dhe blej nga importi’, metamorfozë si kjo e LV-së nuk e njeh historia e re politike e Kosovës. Erdhën në pushtet duke rrokullisur kamionë me mallra nga Serbia, hoqën dorë nga pushteti sepse nuk pranonin të hiqej taksa 100% për produktet serbe, e vendosur në kohën kur ishte kryeministër Ramush Haradinaj. Pas më shumë se katër viteve në pushtet, sot janë kundër çdo biznesi

vendor dhe në përkrahje të mafies energjetike”, ka thënë ajo. Deputetja Bajrami ka theksuar se Kosova ka deficit tregtar rreth 38 miliardë euro për vitet 2001 - 2021 dhe i ka 19 miliardë deficit vetëm gjatë qeverisjes së Kurtit. “Deputeti Kurti ka shpërndarë qindra miliona të buxhetit për të blerë paqe sociale e vota, por asnjë veprim nuk ka ndërmarrë për ta ndihmuar ekonominë e këtij vendi, e cila do të ndihmonte mirëqenien e secilit qytetar. Shënim: Nesër në ora 14:00, ne i kemi ftuar shoqatat e biznesit, ZRRE-në, Autoritetin e Konkurrencës dhe KESCO-n për të argumentuar se tash për tash nuk mund të bëhet liberalizimi i tregut të energjisë pa konkurrencë në treg, për keqinterpretimin e nenit 37 të Ligjit për Energji Elektrike dhe për t'u zotuar si deputetë se për aq sa është në kompetencën tonë, ne do të merremi seriozisht me këtë çështje. Nëse ka ndonjë shoqatë që s'ka marrë ftesë dhe anëtarët e tyre ndikohen nga ky proces! Jeni të mirëseardhur!”, ka shkruar deputetja Bajrami.

Skemë e re mbështetëse për prodhuesit vendorë

PRISHTINË, 20 MAJ - Ministria e Ekonomisë, Artane Rizvanolli, ka thënë se për prodhuesit vendorë po finalizojnë një skemë të re mbështetëse për t'i ndihmuar të përballen me liberalizimin e tregut të energjisë. “Me mbështetjen e LuxDev - Luxembourg Development Cooperation Agency, do t'i përkrahim për izolim të ndërtesave, sisteme solare fotovoltaike (FV) për prodhim të energjisë, sisteme solare termike për ngrohje të ujit, bateri për sisteme solare FV, si dhe rregullatorë të fuqisë reaktive që ulin konsumin e energjisë reaktive dhe rrisin

eficiencën e pajisjeve që veçse përdoren nga ndërmarrjet. Kjo do të thotë më pak kosto energjie, më shumë konkurrueshmëri dhe më shumë siguri për çdo biznes që prodhon në Kosovë”, ka shkruar Rizvanolli në “Facebook”. Ajo ka theksuar se me këto dhe me masa të tjera që qeveria mund të ndërmarrë do t'u qëndrojnë pranë prodhuesve vendorë. “Së bashku me kryeministrin Albin Kurti, Zëvendëskryeministrin, Besnik Bislimi, Ministren e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, Rozeta Hajdari diskutuam me

përfaqësues të odave e bizneseve vendore në Forumin ‘Liberalizimi i Tregut të Energjisë Elektrike: Efektet dhe Masat Lehtësuese’, pjesë e Platformës për Dialogun Publiko-Privat. Qeveria e Republikës së Kosovës mbetet partner i afërt i sektorit privat, si në përballjen me sfidat, ashtu edhe në rritjen e tij. Prandaj, diskutime të tilla janë kyçe për të identifikuar nevojat specifike të bizneseve në mënyrë që të hartojmë politika dhe të ndërmarrim masa për t'i targetuar specifikisht ato”, ka deklaruar Rizvanolli.



ÇFARË KANË NË TRU NJERËZIT E PUSHTETSHËM?

Vuajtja nga çrregullime psikike mund t'i bëjë liderët më të përshtatshëm për të qeverisur. Fjalë e psikiatrit Nassir Ghaemi, i cili “ul në divan” edhe Trump-in



Që nga lufta e nxituar e tarifave, te retweet-et zyrtare të Shtëpisë së Bardhë ku Trump shfaqej si Papa ose si Luke Skywalker, deri te dyshimi i tij shqetësues për Kushtetutën («Nuk e di nëse duhet ta respektoj»): veprimet e fundit të Z. President lënë të mendohet se ka humbur arsyen. Por, përtej këtij rasti specifik, po sikur të jetë pikërisht një gjendje e luhatshme mendore ajo më e përshtatshme për një burrë shteti? Kjo është teza provokuese që hedh psikiatri Nassir Ghaemi, profesor në Universitetin Tufts, në librin “Një çmenduri e jashtëzakonshme. Histori të çrregullimeve mendore të liderëve të mëdhenj”. Sipas Ghaemi-t, liderët shumë të ekuilibruar janë idealë në kohë paqeje dhe mirëqenieje, ndërsa në periudha të vështira, të kesh ndonjë çrregullim psikik mund të të japë avantazh. «Gjatë krizave gjeopolitike apo ekonomike duhen liderë realistë, krijues, të qëndrueshëm dhe empatikë», shpjegon Ghaemi. «Studime të ndryshme tregojnë se këto katër karakteristika janë shpesh më të theksuara tek personat që vuajnë nga çrregullime psikiatrike si çrregullimi bipolar, ku fazat depressive ndërthuren me periudha

maniakale. Depresivët janë zakonisht më realistë dhe empatikë, ndërsa gjatë fazës maniakale shfaqen energji, kreativitet dhe rezistencë ndaj stresit». Ghaemi e mbështet tezën e tij me metodën e psikobiografisë: një lloj diagnoze e bazuar në dokumente që ndihmojnë në rindërtimin e faktorëve kryesorë, edhe gjenetikë, të figurave të mëdha historike. Një rast shembullor është ai i Abraham Lincolnit, president i SHBA-së nga viti 1861 deri në vitin 1865. «Vuante në mënyrë të përsëritur nga depresioni, deri në atë pikë sa të afërmit e tij, kur ishte i ri, i fshihnin thikat nga frika se mos priste damarët», tregon autori. «Por pikërisht depresioni, duke ia hequr filtrin rozë realitetit, i dha një qartësi të jashtëzakonshme: përballoi çështjen e skllavërisë me vendosmëri. U përpoq deri në fund të shmangte luftën civile, dhe më pas e fitoi atë falë aftësisë së tij analitike. Tregoi empati edhe për rebelët e Jugut, duke urdhëruar që udhëheqësit e tyre të mos dënoheshin me vdekje». Edhe Winston Churchill kishte dobësi që rezultuan fitimprurëse. «Vuante nga ciklotimia, një formë e lehtë e çrregullimit


bipolar. Alternonte periudha depresioni, që ai i quante “qeni i zi”, gjatë të cilave mezi ngrihej nga krevati, me faza lehtësisht maniakale ku ishte brilant dhe i pandalshëm. Ishte “realizmi i tij depresiv” që i bëri të mundur të kuptonte me kohë kërcënimin e Hitlerit, ndërkohë që paraardhësi i tij Neville Chamberlain kultivonte trëndafila dhe iluzione për kancelarin gjerman». Churchill tregoi gjithashtu shumë empati ndaj bashkëkombësve të tij. «Megjithëse ishte konservator, luftoi për klasën punëtore dhe të varfrit», thotë psikiatri. «Në vitet '20, gjatë mirëqenies ekonomike, dështoi si ministër Financash dhe, për shkak të ciklotimisë dhe irritimit, kishte pak miq. Por gjatë luftës u bë luani britanik që të gjithë e admirojnë».

Dhimbja e Gandhi-t

Edhe Mahatma Gandhi u prek nga vuajtjet e jetës: «Në rini vuante nga depresioni dhe mendimet vetëvrasëse. Gjatë jetës pati disa faza në të cilat mendonte se vuante nga sëmundje të rënda: nga dokumentet historike mund të klasifikohet si i prekur nga disimia, apo depresion kronik i

lehtë», shpjegon Ghaemi. «Por ishte pikërisht ajo përballje intime me brishtësinë që formësoi te ai një empati radikale, e cila e shtynte të ishte dashamirës – por jo i dorëzuar – edhe ndaj armiqve». Një filozofi i jodhunës që ndikoi edhe te Martin Luther King. «Edhe ai ishte klinikisht depresiv, dhe aftësia e tij për t'u identifikuar me të tjerët buronte më shumë nga përvoja personale e dhimbjes shpirtërore, sesa nga mësimet morale», vëren studiuesi. «Një udhëtim i brendshëm që ai e shndërroi në një forcë të pathyeshme». Prejardhje krejtësisht fizike kishte vuajtja e Franklin Delano Rooseveltit: «Poliomieliti e detyroi të përdorte karrige me rrota që në moshën 39-vjeçare, por temperament i tij hipertimik – një gjendje maniakale e lehtë dhe e qëndrueshme e karakterizuar nga energji e lartë dhe rezistencë ndaj stresit – e bëri të aftë të përballonte me sukses Depresionin e Madh dhe Luftën e Dytë Botërore». As John Fitzgerald Kennedy nuk gëzonte shëndet të mirë: «Vuante nga sëmundja e Addison-it, e trajtuar me ilaçe hormonale shumë të rënda, dhe kishte një shtyllë kurrizore të dëmtuar. Edhe ai ishte hipertimik, me tipare të thek-

suara maniakale: hiperaktivitet, pagjumësi, dëshirë seksuale të lartë dhe humor të ndryshueshëm», shpjegon studiuesi. «Forma e tij e lehtë e manisë ishte rrënja e karizmës së tij të pafundme, edhe pse në vitin e parë të presidencës ilaçet që mernte përforcuan tiparet maniakale, duke ndikuar në vendime të nxituara si pushtimi i dështuar i Kubës. Kur ndërpreu trajtimin hormonal, gjeti një ekuilibër më funksional, duke përballuar me qartësi krizën e raketave dhe duke promovuar reforma të rëndësishme për të drejtat civile». Po Trumpi? «Edhe ai është një hipertimik: energji e madhe, nevojë e vogël për gjumë, vetëvlerësim i tepruar dhe impulsivitet i fortë. Në kontekste krize, ky temperament mund të ndihmojë kreativitetin dhe rezistencën ndaj stresit, por në periudha stabiliteti mund të çojë në vendime agresive dhe jofunksionale si tarifat apo menaxhimi tiranik i emigracionit», përfundon psikiatri. «Çështja nuk është nëse Trump është “i sëmurë” apo “i shëndetshëm”, por nëse psikika e tij është e përshtatshme për momentin historik që po kalon Amerika: sipas të gjitha gjasave, nuk duket se është». / bota.al



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

Kastrioti e pret titullin gjatë, Rahoveci në çastin më të mirë në histori

FERIZAJ, 20 MAJ - Të enjten zhvillohet ndeshja e dytë finale e plejofit në Superligën e Kosovës në hendboll në konkurrencë të meshkujve në mes të Kastriotit dhe Rahovecit. Ndeshjen e parë, të luajtur të dielën mbrëma, e fitoi Rahoveci. Ndeshja ishte shumë e fortë, me shumë duele e gola të bukur. Njëjtë

pritet të jetë edhe të enjten prej orës 20:00 në palestrën “Bill Clinton” në Ferizaj. Vendësit synojnë fitore për ta dërguar serinë finale në ndeshjen e tretë. Ndërkohë “vreshtarët” udhëtojnë për ta festuar titullin. Rahoveci është në çastin më të mirë si klub. Vjet e fitoi titullin e parë të kampionit, ndërsa bëri paraqitje të mirë

edhe në Evropë. Këtë edicion garues pjesën e rregullt të garave e përfundoi pa humbje të pësuar. Në gjysmëfinale e eliminoi Prishtinën. Edhe Kastrioti është në çast shumë të mirë. Ka fituar Kupën e Kosovës në turneun e organizuar në Ferizaj. Në finale ishin mbi 3000 shikues në palestër. Kupën e Kosovës skuadra

ferizajase e fitoi për herë të dytë rresht, por titullin e fundit të kampionit Kastrioti e ka fituar në vitin 2011. Prej atëherë ka dominuar skuadra pejane, Besa Famgas, të cilën Kastrioti e mposhti në gjysmëfinale të plejofit dhe në finale të Kupës. Kastrioti është klub pasardhës i Borcit të famshëm. Është klubi më i suksesshëm në histori të



hendbollit të Kosovës dhe prej klubeve më të suksesshme në të gjitha sportet.

Trepça kërkon titullin, Bashkimi serinë finale

MITROVICË, 20 MAJ - Finalët e “play-off”-it të Pro Credit Superligës po dhurojnë emocione të jashtëzakonshme, me atmosferë fantastike dhe ndeshje të bukura në parket. Çdo ndeshje është shumë e rëndësishme dhe luftohet deri në sekondën e fundit për çdo top. Seria finale e “play-off”-it zhvendoset në Mitrovicë, ku përballen Trepça dhe Bashkimi, dy skuadrat që ishin renditur në dy pozitat e para në garat e rregullta. Seria finale është 3:2 për “Xehetarët”. Nëse fiton Trepça, atëherë do ta mbrojë titullin e kampiones, ndërsa “portokallezinjtë” luftojnë për fitore për ta barazuar serinë finale në 3:3, në mënyrë që

finalja vendimtare të jetë të dielën në Prizren. Ndeshjen e parë e fituan prizrenasit 84:77, e më pas fituan tri takime radhazi mitrovicasit 79:72, 71:88 dhe 80:74, ndërsa sfidën e fundit “portokallezinjtë” 85:77. Këto dy skuadra u përballën katër herë në edicionin e rregullt me nga dy fitore secila skuadër, po ashtu ishin përballuar edhe në finalen e Kupës, ku triumfuan “Xehetarët”. Ndeshja zhvillohet të mërkurën në Palestrën “Minatori” nga ora 19:00 dhe transmetohet në “Art Motion” dhe “Kujtesa”.

Orari

19:00 Trepça - Bashkimi



Vuçiqi, trajnerit të Serbisë: Mposhteni Shqipërinë

BEOGRAD, 20 MAJ - Shqipëri - Serbi është më shumë sesa një sfidë futbolli pavarësisht se palët e përfshira, dy federatat, përpiqen ta zbusin, pasi nuk dëshirojnë që historia të përsëritet, për më tepër që të dy federatat do të organizojnë së bashku “Euro 2027” për U21. Pavarësisht këtij fakti, në aspektin sportiv dhe jo vetëm, Shqipëri - Serbi është një ndeshje që të dy ekipet përfaqësuese, të dy shtetet, kërkojnë ta fitojnë. Pak ditë pasi mori pjesë në samitin e Tiranës, ku u ul në



tryezë me liderët e Evropës dhe u prit nga kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, presidenti serb Aleksandër Vuçiq zgjodhi një tjetër skenë për t'i dhënë një “urdhër” simbolik trajnerit të kombëtares serbe, Dragan Stojković, që ta mundë Shqipërinë në ndeshjen e 7 qershorit. Në një tubim elektorat, Vuçiqi falënderoi publikisht trajnerin e kombëtares serbe të futbollit, Stojković, për mbështetjen e tij të hapur politike, por ajo që tërhoqi më shumë vëmendje

ishte një deklaratë me tone të ashpra sportive, që në thelb mbante një ngarkesë politike. “E pashë pak më parë dhe tani e shoh që është këtu, ju lutem duartroktoni fort trajnerin serb Dragan Stojković, një legjendë e Nishit, i cili nuk u fsheh si shumë të tjerë dhe erdhi të jetë me ne këtu. Në qershor luani atje kundër Shqipërisë, për t'i mposhtur ata!”, u shpreh Vuçiqi. Deklarata e presidentit vjen pikërisht në prag të ndeshjes Shqipëri - Serbi që do të zhvillohet më 7 qershor.

Khaka në ‘Ekipin e Vitit’ në Bundesligë

LEVERKUSEN, 20 MAJ - Mesfushori Granit Khaka e kaloi një tjetër sezon brilant në nivelin personal. Ndonëse i munguan sukseset ekipore, për dallim nga edicioni i paharrueshëm 2023/24, ylli i Kosovës ishte motori i Bayer Leverkusenit

edhe në edicionin 2024/25. Për këtë, “Opta” e ka përfshirë përfaqësuesin zviceran në “Ekipin e Vitit”, të cilin e publikoi sot “Livescore”. Ish-futbollisti i Baselit, Borussia Monchengladbachut e Arsenalit e gjen veten në mesfushë

përkrah yjeve si Kimmich e Wirtz në mesfushën me tre, ndërsa përpara tyre gjenden Olise, Kane e Schick. Mbrojtja përbëhet nga katërshja: Ryerson, Tah, Upamecano e Davies, kurse në portë është vendosur Dahmen. Khaka me shokë nuk arritën të

fitonin trofe në këtë edicion, megjithatë bën paraqitje pozitive nën drejtimin e trajnerit Xabi Alonso, i cili u largua përfundimisht nga kuqezinjtë dhe pritët që shumë shpejt të zyrtarizohet trajner i ri i Real Madridit.



Tare është zgjedhja e parë për Milanin

Milano, 20 maj - Kontaktet mes Igli Tares dhe Milanit nuk janë shkëputur kurrë. Prej muajsh klubi kuqezi po kërkon një drejtor sportiv “klasik”, siç ka thënë edhe administratori Giorgio Furlani në një intervistë për “Sportmediaset”. Që prej atij momenti shumë emra kanë

qarkulluar për pozicionin e lirë në Milanello: Paratici, Sartori, D’Amico, Manna, Congerton, por njëri ka mbetur gjithmonë në lojë: Igli Tare. Ish-drejtuksi i Lazios shihet si kandidat shumë serioz për t’u bërë drejtor sportiv i ri i Milanit. Sipas medieve italiane, ditët e fundit ka pasur

një kontakt telefonik mes Tares dhe drejtuesve të Milanit, me një marrëveshje për të biseduar sërish së shpejti. Madje në fund të prillit janë zhvilluar edhe dy takime mes Tares dhe Furlanit, ku është diskutuar vizioni për Milanin e së ardhmes. Më pas, gjithçka kaloi në heshtje për

shkak të përqendrimit të finalja e Kupës së Italisë dhe diskutimeve të brendshme në klub për një vendim që konsiderohet thelbësor për projektin afatgjatë të Milanit. Tani që sezoni është praktikisht i mbyllur, pritet që të merret vendimi përfundimtar.



KFF Dukagjini fiton Kupën e Kosovës

KLINË, 20 MAJ - Kupa e Kosovës për edicionin 2024/2025 i ka takuar KFF Dukagjini. Skuadra nga Klina e ka mposhtur KFF Mitrovica pas penalltive, me rezultat 6:5, duke realizuar suksesin e parë në histori të klubit. Ndeshja pas kohës së rregullt dhe vazhdimëve dy herë nga 15 minuta u mbyll baras, 1:1. Ishin mitrovicaset ato të cilat kaluan në epërsi në minutën e 28, me një gol të realizuar nga Marigona Tahiri nga distanca. Megjithatë, Dukagjini reagoi në pjesën e dytë dhe arriti t’i barazojë shifrat në minutën e 62-të përmes kapitenes Gjenifer Pjetri. Më pas përkundër disa rasteve të krijuara nga të dyja ekipet rezultati nuk ndryshoi dhe kësaj fituese u përcaktua përmes penalltive. Në serinë e 11-metërshave më të sakta u treguan futbollistët e Dukagjinit, duke shijuar gëzimin e kësaj finaleje. Trofeun për kapitenen Gjenifer Pjetri e ndau presidenti



i FFK-së, Agim Ademi, ndërsa medaljet u ndanë nga Vjolla Krasniqi, anëtare e KE të FFK-së, Valbona Gashi Uka, shefe e futbollit të femrave në FFK, si dhe Lendita Cena, kryetare e Komisionit të Garave për futbollin e femrave. Ndërkohë, kreu i FFK-së, Agim Ademi, ka uruar KFF Dukagjinin për suksesin historik përmes një mesazhi në rrjetet sociale. “Ky trofe është dëshmi e punës dhe përkushtimit të vajzave të jashtëzakonshme, stafit teknik dhe gjithë klubit, që me profesionalizëm e besim nuk u

dorëzuan, por luftuan deri në fund që sezonin ta mbyllin me trofe. Urime për këtë moment historik dhe për trofeun që i jep krenari qytetit të Klinës dhe gjithë bashkëqytetarëve tuaj”, ka thënë Ademi. Kujtojmë që vetëm pak ditë më parë KFF Mitrovica u shpall kampion i Superligës së Femrave, pasi në ndeshjen e fundit të kampionatit e mposhti Dukagjinin në Klinë me rezultat 1:0. Do të jetë pikërisht skuadra mitrovicase ajo që edhe sivjet do ta përfaqësojë Kosovën në garat evropiane.

Guardiola ‘qan’ largimin e De Bruynes: Është i dyti pas Messit

MANCHESTER, 20 MAJ - Kevin De Bruyne do t’u thotë lamtumirë tifozëve të Manchester Cityt këtë të martë në “Etihad Stadium”, pas një dekade të mbushur me suksese në radhët e kampionëve të Anglisë. Mesfushori belg, që nuk do të marrë pjesë në Kupën e Botës për Klube me Cityn, do ta luajë ndeshjen e fundit në shtëpi ndaj Bournemouthit, ndërsa fundjava do ta mbyllë përfundimisht kapitullin e tij “blu” me sfidën kundër Fulhamit. Në konferencën për shtypin përpara sfidës me Bournemouthin, trajneri Pep Guardiola nuk i kurseu lavdërimet për njeriun që ka qenë zemra e skuadrës së tij për më shumë se një dekadë. “Do të jetë shumë e vështirë të gjejmë një tjetër si ai”, ka thënë Guardiola. “Ai është ndër tre më të mirët që kam parë ndonjëherë. Njëri është Messi, më i miri që kam parë, sepse ai e bën gjithçka shumë afër



zonës. Hmm... le ta mendoj... po, do ta vendos Kevinin të dytin. Ka statistikë, golat, asistimet, gjithçka që i jep skuadrës në një të tretën e fundit të fushës. Është një talent i rrallë. Prandaj ka qenë një nga lojtarët më të mëdhenj në historinë e këtij klubi”. Që nga transferimi i tij nga Wolfsburgu në vitin 2015, De Bruyne ka fituar 16 trofe me Manchester Cityn, përfshirë

gjashtë tituj të Premierë Ligës dhe një Ligë të Kampionëve në vitin 2023. Të martën tifozët e “Etihad”-it do ta përshëndesin për herë të fundit idhullin e tyre. Dhe ndërsa një epokë mbyllet për De Bruynen, trashëgimia që ai lë pas është e pamatshme një nga më të mirët që ka veshur ndonjëherë fanellën e Cityt dhe, sipas Guardiols, një prej të paktëve që mund të qëndrojnë në krah të Lionel Messit.

SHKURT

Kosova rrëmben gjashtë medalje në Kupën e Botës në Kick-boks

Ekipi i kick-boksit i Kosovës është kthyer me gjashtë medalje, dy të argjendta dhe katër të bronzta, nga gara prestigjioze ndërkombëtare “Wako Turkish Open”, e mbajtur nga 14 deri më 18 maj në Antalia të Turqisë. Medaljet e argjendta i siguruan Nart Mehmeti dhe Gent Hyseni. Mehmeti shënoi tri fitore, ndërsa Hyseni dy sosh, njoftoi Komiteti Olimpik i Kosovës në “Facebook”. Në podium u ngjitën edhe katër sportistë të tjerë me medalje të bronzta: Artor Mehmeti dhe Omar Thaçi, që realizuan nga dy fitore secili, si dhe Donjeta Menxhiqi dhe Gëzimi Morina, të cilët fituan nga një luftë.

Agjenti i Kloppit mohon marrëveshjen me Romën

“Jurgen Klopp ka thënë ‘po’ për ta marrë drejtimin e Romës”. Kjo ishte “bomba” që hodhi në qarkullim të hënën gazeta prestigjioze italiane “La Stampa”, duke tronditur opinionin sportiv dhe tifozët verdhekuq, të cilët nisën ta ëndërronin trajnerin legjendar në bankinën e skuadrës kryeqytetase. Sipas burimit, pronarët Friedkin i kishin bërë një ofertë zyrtare gjermanit mbrëmjen e 18 majit, pas përfundimit të ndeshjes kundër Milanit, por entuziazmi nuk zgjati shumë. Vetëm pak orë më vonë agjenti i Kloppit, Marc Kopicke, hodhi poshtë gjithçka duke folur për median arabe “winwinallsports”. “Kam lexuar lajmin që Kloppi do të bëhet trajner i Romës, por nuk ka asgjë të vërtetë në këtë”, ka deklaruar shkurtimisht ai. Fjalët e Kopicke përfaqësojnë një goditje të fortë për shpresat e tifozëve romanistë, të cilët kishin filluar të besonin në këtë skenar pas disa sinjaleve në rrjetet sociale dhe një video të shpërndarë nga pronarët Friedkin që u interpretua si një “indeks” drejt ardhjes së Kloppit.

Flick rinovon me Barçën, gati firma edhe për Yamalin

Një Spanjë nuk ka më asnjë dyshim: Hansi Flick rinovon kontratën me Barcelonën deri më 2027. “Mundo Deportivo” zbulon se palët kanë gjetur akordin total ndërmjet tyre për ta rinovuar kontratën edhe për një tjetër vit, pasi kontrata aktuale përfundonte më 2026. Në sezonin e tij të parë në krye të ekipit blaugrana, tekniku gjerman fitoi tre trofe, mes tyre edhe La Liga, por ajo që kënaq stafin drejtues dhe tifozët është filozofia e tij, një futboll i bukur ofensiv. Prej kohësh Laporta e kishte paralajmëruar këtë, por vendimi zyrtar pritej vetëm pas përfundimit të sezonit. Jo vetëm Flick, Laporta paralajmëroi edhe rinovimin e kontratës me Lamine Yamal.

Juventusit në garë për Hernandezin

Juventusit ka hedhur sytë nga një emër i madh për ta përforcuar krahun e majtë të mbrojtjes, Teo Hernandez. Sipas informacioneve të bujshme nga mediet italiane, klubi torinez ka filluar të bëjë lëvizje konkrete për ta sjellë yllin e Milanit në Torino. Megjithatë, transferimi i tij nuk do të jetë i thjeshtë. Juventusit duhet të ofrojë të paktën 54 milionë euro për ta bindur Milanin ta lejojë largimin e francezit. Një pengesë e madhe për këtë transferim është nevoja e Juventusit për ta shitur Andrea Kambiazon për t’i gjetur paratë e nevojshme, njëkohësisht edhe për ta bindur Milanin që ta lejojë mbrojtësin më të vlerësuar të skuadrës të largohet te një rival direkt.

Reali përgatit ceremoninë madhështore për Ancelottin

Të shtunën e ardhshme Carlo Ancelotti do ta drejtojë për herë të fundit Real Madridin në ndeshjen kundër Real Sociedadit në “Santiago Bernabeu”, duke mbyllur një kapitull të lavdishëm në

historinë e klubit. Me 15 trofe të fituar në dy periudha si trajner i “Los Blancos”, Ancelotti është bërë trajneri më i suksesshëm në historinë 123-vjeçare të klubit, duke tejkaluar legjenda si Miguel

Munoz dhe Zinedine Zidane. Pas përfundimit të sezonit, Ancelotti do ta marrë drejtimin e kombëtares së Brazilit, duke nisur një sfidë të re në karrierën e tij të pasur.

Për nder të kontributit të tij të jashtëzakonshëm, Real Madridi ka planifikuar një ceremoni lamtumire pas ndeshjes së fundit në “Bernabeu”, ku do të ekspozohen të 15 trofetë e fituar

nën drejtimin e Ancelottit. Ky moment do ta shënojë fundin e një epoke të ndritur për Real Madridin dhe fillimin e një kapitulli të ri nën drejtimin e trajnerit të ardhshëm, Xabi Alonso.

Lume's Details

Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lume's Details

[lumesdetails](#)

Mbrapa Teatr it, 4 Llullat, Rr. Bajram Kelmendi

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Beldoho” SH.P.K. me seli në Gjiilan, Pronar Doruntinë Hogoshti, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 812067636 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBVESTENJE

Obavestavanje se svi klijenti da društvo sa "Beldoho" D.O.O. Gnjilane, Doruntinë Hogoshti donelo odluku o prestani rada sa nrb. 812067636 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klijenti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform all customers that the limited liability “Beldoho” L.L.C. with headquarters Gjilan, Doruntinë Hogoshti has come to the decision to quit its business: 812067636 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë

facebook 

www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156  +386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- "L&M Group Partners" SH.P.K. me nr. Unik Identifikues: 812258300 bënë shpallje në gazetë për zvogëlim të kapitalit nga 300 mijë në 50 mijë Euro.

- Për informata më të hollësishme
na kontaktoni në numrin
e telefonit: 044-162-783.

- Florinda Vehapi shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 1.2.3.4 dhe diplomën e sh.m. Mjekësisë “Hysni Zajmi” Gjakovë.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Uran Haraqija B.I. nga Gjakova shpall
të pavlefshme numrin Unik
Identifikues: 811131656 lëshuar nga
ATK.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

- Zenel Lota B.I. nga Gjakova shpall të pavlefshme numrin Unik Identifikues: 811142348 lëshuar nga ATK.

- Haxhi Shenaraj shpall të pavlefshme diplomën e sh.m Teknike "Nexhmedin Nixha" Gjakovë.

- Ismet Hasi shpall të pavlefshme dëftesat e kl. X,XI,XII,XIII dhe diplomën e sh.m. Mjekësisë "Hysni Zajmi" Gjakovë.

- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për informund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.

- Arian Lota shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 1.2.3.4 dhe diplomën e sh.m. Mjekësisë "Hysni Zajmi" Giakovë.

- Lëshoj banesën një dhomshe me qira
 , ne lagjen Dardania afër
 Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroj
 i Bardhe, banesa është e mobiluar
 tërësisht. Për informata lajmërohu-
 ni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.



ROYAL CROWN

RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

Columbus, Georgia, USA
Since 1905

Columbus, Georgia, USA
Since 1905
0.5L

MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992

